



Republika e Kosovës

Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Istog

Skupština Opštine Istok
Municipal Assembly Istog

Komitetit për Politikë dhe Financa/Komitet za Politiku i Financije/ Policy and Finance Committee

35	P r o c e s v e r b a l
Tipi i mbledhjes:	Mbledhje e rregullt e KPF-së
Data e mbajtjes:	23.04.2021 në ora 10:00
Mbledhjen e kryesoi:	Qaush Balaj, Kryesues i Kuvendit
Procesmbajtës:	Vjosa Hysenaj, Zyrtare e Lartë për Punë Profesionale të Kuvendit të Komunës së Istogut
Pjesëmarrës anëtarët e KPF-së	Zenel Shatri, Haki Podrimaj, Besa Ferati, Eliot Kukiqi, Ajshe Metaj dhe Ardita Idrizaj
Mungojnë:	
Pjesëmarrës të tjerë:	Nënkryetari i Komunës z. Agim Ademaj, Drejtorët: Drin Sadikaj, Enver Rugova, Hysni Maxharraj, Hazbi Bajraj, Edona Bujupi Logja, Lulyim Shoshi, Iulyim Blakaj, Zyrtar Administrativ: Isa Hoxh, Zekie Sutaj, Ardon Arifaj, Flora Bujupaj, Fjollë Berisha.
Shqyrtimi i pikës 1.	
Diskutimet:	
Kryesuesi i kuvendit z. Qaush Balaj- Konstatimi i prezencës së anëtareve të Kuvendit, Konstatoj që prezent janë 7 anëtar te Komitetit për Politikë e Financa, Kuorumi është dhe mund të fillojmë me pikat në vazhdim.	
Vendimet:	
Vazhdojmë me mbledhjen	
Personat përgjegjës për zbatim:	Shërbimi për punë të kuvendit
Afati për zbatim:	Shërbimi për punë të kuvendit
Rendi i ditës:	
1. Konstatimi i prezencës së anëtarëve të Komitetit,	

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të datës 26.02.2021,
3. Shqyrtimi dhe debatimi i Raportit financiar për periudhën Janar- Mars të vitit fiskal 2021,
4. Marrja e vendimi për bartjen e mjeteve të pashpenzuara nga viti 2019dhe 2020 në vitin 2021,
5. Marrja e vendimi për destinimin e mjeteve financiare nga reyervat, në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale,
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft Rregullores për Perkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijëve,
7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim – Vendimit për dhenjën në shfrztëzim të pronës së paluajtshme të komunë, njësia kadastrale 257-0 për varreza zona kadastrale Vrellë.
8. Njoftimi me Raportin e punës së Ndërmarrjes Publike Lokale “Ambienti” Istog, Janar-Dhjetor 2020.

Diskutimet:

Kryesuesi i Kuvendit z. Qaush Balaj - përshëndeti të pranishmit, kushtet janë plotësuar për mbajtjen e kësaj mbledhje. Në mbrojtje të infektimit nga pandemia dhe respektimit të masave ndaj virusit Covid 19, Salla që jemi tani është dezinfektuar, anëtarët e komitetit si dhe të pranishmit tjerë janë pajisur me maska, dorëza dhe dezinfektues në tavolina.

Hapi punimet për këtë mbledhje me pikat e rendit të ditës të parapara për këtë mbledhje.

Prezanton rendin e ditës,

Pyet nëse ka dikush ndonjë pyetje apo sugjerim para miratimit të rendit të ditës;

Pasi qe nuk ka dikush diçka,

Hedh në votim rendin e ditës.

Miratohet rendi i ditës unanimit.

Vendimet:

Miratohet rendi i ditës në mënyrë unanime.

Personat përgjegjës për zbatim:

Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim:

Deri në mbledhjen e kuvendit

Shqyrtimi i pikës 2.

Diskutimet:

Kryesuesi i kuvendit z. Qaush Balaj - vazhdojmë më pikën e dytë të rendit të ditës: Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar, materialin e keni pasur dhe keni mundur ta analizoni. a ka dikush diçka?

Pasi që diskutime nuk pati hedh në miratim.

Miratohet një zëri procesverbali nga mbledhja e kaluara.

Vendimet:

Miratohen njëzëri procesverbali nga mbledhja e kaluar, pa vërejtje.

Personat përgjegjës për zbatim:

Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim:

Shërbimi për punë të kuvendit

Shqyrtimi i pikës 3.

Diskutimet:

Kryesuesi i kuvendit z. Qaush Balaj -vazhdojmë më pikën e tretë të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe debatimi i Raportit financiar për periudhën Janar- Mars të vitit fiskal 2021, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës ja kaloj fjalën Zyrtarit Kryesor Financiar z. Osman Sadikaj.

Osman Sadikaj- përshëndet të gjithë të pranishmit, prezanton dhe sqaron Raportin financiar për periudhën Janar- Mars të vitit fiskal 2021.

Kryesuesi i kuvendit z. Qaush Balaj – pasi qe diskutime nuk ka kalojmë në pikën e radhës

Vendimet:

Pasi që vërejtje dhe diskutime të tjera, nuk pati KPF -ja në mënyre unanime: Raportin financiar për periudhën Janar- Mars të vitit fiskal 2021, ia kalon Kuvendit të Komunës për shqyrtim.

Personat përgjegjës për zbatim: Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim: Deri në mbledhjen e kuvendit

Shqyrtimi i pikës 4.

Kryesuesi i kuvendit z. Qaush Balaj, vazhdojmë më pikën e katertë të rendit të ditës: Marrja e vendimi për bartjen e mjeteve të pashpenzuara nga viti 2019 dhe 2020 në vitin 2021, raportin e keni pasur në material, prandaj unë rreth kësaj i jap fjalën zyrtarit Kryesor Financiar z. Osman Sadikaj.

Osman Sadikaj – benë prezantimin dhe sqaron për bartjen e mjeteve të pashpenzuara nga viti 2019 dhe 2020 në vitin 2021.

Zenel Shatri – përshëndet të gjithë të pranishmit, pyet pse nuk ka përfunduar ende kubzimi i trotuarit në Tomoc.

Osmon Sadikaj – nuk ka pasur mjete të mjaftueshme .

Zenel Shatri – nga këto rezerva 5mijë euro ti shtohen projektit ndërtimi i trotuarit në fshatin Tomoc.

Lulzim Blakaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, propozon që 16 mijë euro të shkojnë në ndërtimin e rrugës në fshatin Kshicë dhe ndërtimin e rrugëve në Istog.

Ardita Idriyaj – përshëndet të gjithë të pranishmit, propozon që 12 mijë euro i shtohen projektit Rregullimi i kanalit në fshatin Lubozh.

Lulzim Shoshi – përshëndet të gjithë të pranishmit, betonimi i kanalit në fshatin Muzhevin.

Pas shumë diskutimesh në sall anëtarët e KPF-së propozuan që këto mjete siç janë të cekura në bartje ti kalohen kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit – pasi qe diskutime tjera nuk ka hedhe në miratim, me këto propozime nga anëtarët e KPF-së12 mijë euro i shtohen projektit Rregullimi i kanalit në fshatin Lubozh Pesë 5 mijë euro i shtohen projektit ndërtimi i trotuarit në fshatin Tomoc.

Miratohet unanim nga anëtarët e KPF-së	
Diskutimet:	
Vendimet:	
Pasi që vërejtje dhe diskutime të tjera, nuk pati KPF -ja në mënyre unanime: bartjen e mjeteve të pashpenzuara nga viti 2019 dhe 2020 në vitin 2021, ja kalon Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim me këto propozime: 12 mijë euro i shtohen projektit Rregullimi i kanalit në fshatin Lubozh Pesë 5 mijë euro i shtohen projektit ndërtimi i trotuarit në fshatin Tomoc.	
Personat përgjegjës për zbatim:	Shërbimi për punë të kuvendit
Afati për zbatim:	Deri në mbledhjen e kuvendit
Shqyrtimi i pikës 5.	
Diskutimet:	
Kryesuesi i kuvendit z. Qaush Balaj, po vazhdojmë më pikën e pestë të rendit të ditës, Marrja e vendimi për destinimin e mjeteve financiare nga rezervat, në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale, lidhur me këtë fjalën ja kalojë Zyrtarit Kryesor Financiar z. Osman Sadikaj..	
Osman Sadikaj - bënë prezantimin dhe sqarimin e destinimin e mjeteve financiare nga rezervat, në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale.	
Pas shumë diskutimesh në sall anëtarët e KPF-së propozuan që këto mjete siç janë të cekura të ndryshojnë neper këto projekte	
<ul style="list-style-type: none"> - Nga rregullimi i varrezave në fshatin Vrellë 85 mijë euro të ndahen në këto projekte: - Asfaltimi i rrugëve në Vrellë 29 mijë euro, - Kubzimi i trotuarit në Kamenic lagja Lipaj 4000 euro, - Rregullimi i varrezave të reja në fshatin Vrellë 52 mijë euro. 	
Kryesuesi i Kuvendit – pasi që diskutime tjera nuk ka hedhe në miratim	
Miratohet unanim nga anëtarët e KPF-së	
Vendimet:	
Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime, KPF unanim rekomandon: destinimin e mjeteve financiare nga rezervat, në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale, dhe të njëjtin ia kalon KK për shqyrtim dhe miratim	
Personat përgjegjës për zbatim:	Shërbimi për punë të kuvendit
Afati për zbatim:	Deri në mbledhjen e kuvendit
Shqyrtimi i pikës 6.	
Kryesuesi i Kuvendit z. Qaush Balaj, vazhdojmë më pikën e gjashtë të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i Draft Rregullores për Përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijëve, Edhe këtë Rregullore e keni pasur me material, kemi pasur mundësi ta shikoni dhe ta analizoni, fjalën ja kaloj drejtoreshës së Administratës, znj. Edona Bujupi Loxha.	

Edona Bujupi Loxha - përshëndet të gjithë të pranishmit, bënë prezantimin dhe sqarimin e Draft Rregullores për Përkujdesjen dhe Mbrojtjen e Fëmijëve,

Kryesuesi i kuvendit z. Qaush Balaj -pasi që diskutime tjera nuk pati, konstatoj që Komiteti i rekomandon në mënyrë unanime të dërgoj për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Komunës Draft Rregullores për Përkujdesjen dhe Mbrojtjen e Fëmijëve.

Vendimet:

Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime, KPF-ja i rekomandon që: Rishqyrtimin e Draft Rregullores për Përkujdesjen dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, ia kalon Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Personat përgjegjës për zbatim: Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim: Deri në mbledhjen e kuvendit

Shqyrtimi i pikës 7.

Kryesuesi i kuvendit z. Qaush Balaj, vazhdojmë më pikën e shtatë të rendit të ditës , Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim - Vendimit për dhenjën në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunë, njësia kadastrale 257-0 për varreza zona kadastrale Vrellë, fjalën ja kaloj drejtorit të drejtorisë për Kadaster dhe Gjeodezi z. Hazbi Bajra.

Hazbi Bajra - përshëndet te gjithë te pranishmit , bënë prezantimin dhe sqarimin e i Propozim - Vendimit për dhenjën në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunë, njësia kadastrale 257-0 për varreza zona kadastrale Vrellë,

- Pas shumë diskutimesh dhe debatesh, pasi qe për te njëjtën çështje është ndarë edhe një prone me vendim te Kuvendit te Komunës ne vitin 2015, anëtarët e KPF-së propozojnë qe kjo pike te hiqet nga rendi i ditës dhe mos ti dërgohet Kuvendit deri sa te sqarohet se cila pronë i epet fshati Vrelle për varreza.

Kryesuesi i kuvendit z. Qaush Balaj -pasi që diskutime tjera nuk pati,

Hedhe në miratim propozimin qe kjo pik te hiqet nga rendi i ditës dhe mos ti dërgohet për shqyrtim dhe miratim anëtareve te Kuvendit.

Miratohet unanimit

Diskutimet:

Vendimet:

Pasi që pati vërejte dhe diskutime te shumta , KPF-ja unanimit rekomandon që : Propozim - Vendimit për dhenjën në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunë, njësia kadastrale 257-0 për varreza zona kadastrale Vrellë, mos t'i kalohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Personat përgjegjës për zbatim: Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim: Deri në mbledhjen e kuvendit

Shqyrtimi i pikës 8.

Kryesuesi i kuvendit z. Qaush Balaj, vazhdojmë më pikën e tetë të rendit të ditës , Njoftimi me Raportin e punës së Ndërmarrjes Publike Lokale "Ambienti" Istog, Janar-Dhjetor 2020., fjalën ja kaloj drejtorit z. Enver Rugova.

Enver Rugova – përshëndet të gjithë të pranishmit, bën prezanton dhe sqarimin e Njoftimi me Raportin e punës së Ndërmarrjes Publike Lokale "Ambienti" Istog, Janar-Dhjetor 2020.

Kryesuesi i kuvendit z. Qaush Balaj -pasi që diskutime tjera nuk pati, konstatoj që Komiteti i rekomandon në mënyrë unanime të dërgoj për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Komunës Njoftimi me Raportin e punës së Ndërmarrjes Publike Lokale "Ambienti" Istog, Janar-Dhjetor 2020.

Diskutimet:

Vendimet:

Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime, KPF-ja rekomandon që : Njoftimi me Raportin e punës së Ndërmarrjes Publike Lokale "Ambienti" Istog, Janar-Dhjetor 2020, t'i kalohet Kuvendit të komunës për shqyrtim dhe miratim.

Personat përgjegjës për zbatim:

Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim:

Deri në mbledhjen e kuvendit

Diskutime tjera:


Kryesuesi i kuvendit z. Qaush Balaj, pasi që përfunduan pikat për këtë rend dite, ju falënderoj për pjesëmarrje dhe kontributin e dhënë.

Shpalli të mbyllura punimet për këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoj :

12:10

Procesmbajtëse,
Znj. Vjosa Hysenaj



Kryesuesi i Kuvendit,
z. Qaush Balaj

